



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1 regjistër (JR)
Datë 08.01.2020

Nr. 11 i vendimit
Datë 31.03.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ardian Hajdari	Relator
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 31.03.2021, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonći Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 1/2020, datë 08.01.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Përparim Kulluri, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda, Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 202, datë 06.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 4, 6, 38, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Përparim Kulluri (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda, Tiranë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas të cilave ka rezultuar:
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar raportet² duke vlerësuar papërshtatshmërinë për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Përparim Kulluri.

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 22.01.2018.

² Raporti fillestar me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, si dhe raporti i përditësuar i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 18.12.2018, të KDZh-së.

5. KLP-ja ka hartuar raportin me nr. {***} prot., datë 02.04.2019, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Ky raport është bazuar në formularin e vetëdeklarimit; në 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; në 5 dosjet hetimore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; në të dhënat nga burimet arkivore të prokurorisë. KLP-ja shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe analizoi të dhënat në 8 dosjet, referuar neneve 71 – 76 për kriteret e vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”).
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 202, datë 06.11.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin 179/b, në pikat 1, 3 e 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1, shkronja “c” e nenit 58 dhe të pikave 2 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda, Tiranë.*
8. Ky vendim është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej kriterëve të vlerësuar.

8.1 *Lidhur me kontrollin e figurës, trupi gjykues vlerëson se për subjektin e rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, u provua papërshtatshmëria për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

8.2. *Lidhur me vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues çmon se: Për pasurinë e identifikuar nr. 5 (numërtimi i pasurive sipas vendimit të Komisionit), subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në kuptim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Në lidhje me burimin e ligjshëm të pasurive nr. 6 dhe 7, të identifikuar në pikën nr. 8, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të dhëna të pavërteta me pasojë sigurimin e vlerës së lartë të përfitimit të të ardhurave nga shpronësimi i objektit “dyqan”, si dhe ligjërimin e burimit të tyre, veprime të cilat vlerësohen si sjellje të subjektit që në raport me ushtrimin e detyrës rëndojnë pozitën e tij, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

8.3 *Lidhur me vlerësimin e aftësisë profesionale, trupi gjykues, gjatë analizës së mangësive profesionale të konstatuara, për një rast i cili për nga rëndësia e veprës penale dhe organi hetimor i caktuar për hetimin e këtyre veprave, çmon se moskryerja e hetimeve të plota nuk identifikohet si shkak i paaftësisë profesionale të subjektit, por konkludohet se mosveprimet e subjektit në çështjen penale, e cila parimisht ndikon edhe interesin e rëndësishëm publik kur nën hetim janë persona të cilëve u janë besuar detyra të rëndësishme, dhe në rast akuzash të ngritura ndaj tyre duhet të ketë hetime intensive dhe transparente, dëshmojnë për sjellje të subjektit në*

mospërbushje të detyrës në pozicionin e prokurorit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

9. Më datë 24.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Komisionit ankimin kundër vendimit nr. 202, datë 06.11.2019, me të cilin është njoftuar më datë 12.12.2019. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor sipas nenit 63³, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Më datë 26.03.2021, subjekti i rivlerësimit solli në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) edhe parashtrimet e tij konform nenit 49, paragrafi 2 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Në konkluzion të ankimit të tij, si edhe në parashtrime, subjekti i rivlerësimit kërkoi që shkaqet e ankimit t’i marrë në shqyrtim Kolegji dhe, në përfundim, kërkoi:

9.1 Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, ligjore, si dhe ato të parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”) ndaj subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda, Tiranë dhe, në momentin e ushtrimit të ankimit, prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

9.2 Ndryshimin e vendimit nr. 202, datë 06.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda, Tiranë dhe aktualisht prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

9.3 Lidhur me shkaqet e ankimit me natyrë procedurale, subjekti i rivlerësimit kërkon nëpërmjet ankimit kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes së tij në Kolegji.

9.3.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Pavarësia tregon mungesën e paragjyimit apo anshmërisë, ekzistenca e paanshmërisë për qëllime të nenit 6 § 1 të KEDNj-së duhet të përcaktohet sipas: i) një testi subjektiv, ku duhet t’i kushtohet vëmendje nëse gjyqtari ka treguar ndonjë paragjykim apo anshmëri personale në një çështje të caktuar; dhe ii) një testi objektiv që do të thotë duke përcaktuar nëse ndryshe nga sjellja personale e ndonjë prej anëtarëve të tij, vetë përbërja e gjykatës ka dhënë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim lidhur me anshmërinë e saj.

9.3.2 Subjekti ka pretenduar në ankim se gjatë procesit të rivlerësimit është shkelur neni 6/1 i KEDNj-së për shkak se nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj. Pavarësisht se me ligj anëtarëve të organeve të rivlerësimit u njihet statusi i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë apo të Gjykatës Kushtetuese, kjo nuk do të thotë se ata janë gjyqtarë. Të gjitha aktet ndërkombëtare të cituara në këtë paragraf, të cilat synojnë të garantojnë pavarësinë e gjyqësorit, kur përcaktojnë se gjysma e organit që cakton masën disiplinore të shkarkimit të jenë gjyqtarë, e kanë fjalën për gjyqtarët apo magjistratët që në momentin e emërimit janë në sistemin gjyqësor dhe emërohen në organin e rivlerësimit nga vetë gjyqtarët apo prokurorët, dhe jo për persona që caktohen nga jashtë sistemit dhe u jepet statusi i gjyqtarit.

³ Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apeliteve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

9.3.3 Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se i është cenuar e drejta e parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së, për shkak se masa e dhënë nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Arsyet e dhëna nga organet e rivlerësimit nuk janë relevante dhe as të mjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë si shkarkimi nga detyra. Është e qartë se arsyet e dhëna nga Komisioni janë krejtësisht të pamjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë, si largimi i menjëhershëm nga detyra, pasi sanksionet disiplinore duhet të jenë proporcionale.

9.3.4 Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se vendimi i Komisionit nuk është logjik. Sipas fakteve të debatuar në seancën dëgjimore dhe nga vetë konkluzionet e Komisionit, pretendon ai, arrihet në konkluzionin se ai nuk ka pasur dijeni që shtetasi M. B. të ketë qenë i dënuar. Pavarësisht këtij fakti që vetë Komisioni konstaton, nga ana tjetër merr masë disiplinore ndaj subjektit pa analizuar elementet e anës subjektive. Në rastin konkret, vendimi i Komisionit është me të dhëna kontradiktore, pra jologjik dhe si i tillë, ai është një akt i paligjshëm.

9.3.5 Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni ka shkelur edhe parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, duke e trajtuar atë në mënyrë të diferencuar, pasi për situata të njëjta objektive me subjekte të tjera rivlerësi, në rastin e tyre ka vendosur konfirmim në detyrë, ndërsa në rastin e ankuesit ka vendosur shkarkimin nga detyra. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mbajtja e standardeve të njëjta të gjyqimit është mjaft e rëndësishme, pasi është në thelb mbrojtje e parimit të sigurisë juridike.

9.4 *Shkaqet e ankimit lidhur me kontrollin e figurës.* Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni nuk ka administruar asnjë provë apo të dhënë të vlefshme, e cila të provojë faktin se shtetasi B. është i dënuar apo i përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu pretendon se në dosje është administruar raporti me "gjetjet" e përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nga i cili "rezulton" se shtetasi A. B. është i dënuar në Greqi. Ky fakt është i pasqyruar vetëm në këtë "gjetje" dhe në asnjë dokument tjetër. Sipas subjektit, nuk ka asnjë provë që të vërtetojë faktin se shtetasi A. apo M. B. të jetë proceduar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

9.4.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ nuk ka asnjë të dhënë që të provojë faktin se ka pasur kontakt me shtetasin M. B. Sipas subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se ka përdorur automjetin me targë {***}, por këtë automjet ia ka dhënë në përdorim shtetasi M. D. dhe jo shtetasi M. B. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kërkesa e Komisionit drejtuar kompanisë celulare "Vodafone" për administrimin e tabulateve telefonike është një veprim i kundërligjshëm, por pavarësisht këtij fakti, nuk është vërtetuar se ka pasur komunikime me shtetasin M. B.

9.4.2 Subjekti i rivlerësimit pretendon se duhet të ekzistojë dijenia e subjektit që një person i caktuar është përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu, duhet të provohet me prova të plota dhe objektive që subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni për ekzistencën e këtyre vendimeve, që një person është i dënuar për krim të organizuar dhe pavarësisht kësaj ai vazhdon të ketë kontakte. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, edhe sikur të merret e mirëqenë për një moment fakti se shtetasi M. B. është dënuar për një nga veprat penale të klasifikuara të kryera nga krimi i organizuar, nuk ka pasur asnjë dijeni për këtë fakt dhe aktet e administruara gjatë hetimit administrativ vërtetojnë deklaratën e tij.

9.5 *Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë.* Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se konkluzioni i pasqyruar nga Komisioni nuk është i vërtetë sepse, sipas

tij, nuk ka paraqitur asnjë dokument fiktiv. E ardhura nga shpronësimi është përfituar bazuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe, si rrjedhojë, Komisioni nuk ka kompetencë të vlerësojë ligjshmërinë e këtij vendimi. Në kërkesën drejtuar Bashkisë {***}, subjekti i rivlerësimit pretendon se shënohet qartësisht se kërkon shpronësimin e dyqanit me sipërfaqe 65,2 m². Sipas tij, kjo e dhënë vërteton plotësisht faktin se nuk ka pasur qëllim që të kërkonte shpronësim për një sipërfaqe më të madhe. Konkluzioni i arritur nga Komisioni që ka ushtruar ndikimin si prokuror, është thjesht një fakt i sajuar, i pambështetur në asnjë të dhënë ose provë të administruar gjatë hetimit administrativ, por i sajuar për të arritur në një vendim të paragjykuar.

9.6 Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vendimi i Komisionit lidhur me kriterin e aftësisë profesionale është jologjik dhe konstatimet e tij nuk qëndrojnë, pasi sipas tij ka hetuar çështjen dhe ka marrë vendimin e pushimit në bazë të fakteve dhe provave të vlerësuara në mënyrë të drejtë. Subjekti thekson se është ngarkuar të ushtrrojë ndjekjen penale në këtë çështje penale disa muaj nga data e cila dyshohej se kishte ndodhur akti korruptiv. Në këto kushte, ishte e pamundur të kryheshin veprime hetimore proaktive, sepse nuk u çmua efektive. Pasi u dëgjuan të gjitha përgjimet e kryera, u administrua vendimi i gjykatës i cili konfirmoi qëndrimin e mbajtur nga prokurorja që po hetohej dhe u analizuan të gjitha provat në tërësi, nuk u bë e mundur të provohej ekzistenca e faktit penal dhe, për këtë arsye, u vendos pushimi i çështjes penale. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka kryer hetimin dhe ka marrë vendimin në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65⁴, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 202, datë 06.11.2019, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

12.1 Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në parashtrimet e datës 26.03.2021 për administrimin e provave⁵ bashkëngjitur parashtrimeve, si dhe shtyrjen e seancës në dhomë këshillimi deri në marrjen e provave të reja, si dhe kërkesën e tij të parashtruar në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

12.2 Kolegji vëren dhe vlerëson se, përveç sa ka parashtruar lidhur me kriteret e kontrollit për të cilat është rivlerësuar, subjekti i rivlerësimit në fund të parashtrimeve të paraqitura më datë 26.03.2021, kërkoi edhe shtyrjen e seancës në dhomë këshillimi deri në deklasifikimin e plotë të raportit të DSIK-së të deklasifikuar pjesërisht. Nga momenti që subjekti i rivlerësimit është njohur me vendimin e arsyetuar të Komisionit dhe deri në momentin që është njoftuar për seancën në dhomë këshillimi në Kolegji, rezultoi se ka pasur kohë të mjaftueshme (rreth 15 muaj) për të kërkuar dhe marrë prova të cilat i vlerësonte se mbështesnin pretendimet e tij në ankim. Si rrjedhojë, kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancës në dhomë këshillimi derisa të bëhet deklasifikimi i plotë i informacionit të klasifikuar të DSIK-së, Kolegji vendosi ta rrëzojë, pasi konsideron se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi që kërkesat e tij t'i paraqiste në afatet e parashikuara procedurale pranë institucioneve përkatëse për sigurimin e provave.

12.3 Pasi e shqyrtoi këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit dhe e vlerësoi atë në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, si edhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit* – Kolegji vendosi që të rrëzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e këtyre provave të reja, pasi vlerëson se kjo kërkesë nuk përmbush parashikimet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

12.4 Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në Kolegji, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar edhe në Kolegji. Kjo edhe për faktin se kërkimi që paraqet subjekti i

⁴ “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

⁵ 1. Shkresa nr. {***} prot., datë 23.03.2021, me lëndë “Kthim përgjigje” e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

2. Kërkesë, datë 24.03.2021, drejtuar Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për deklasifikim të plotë të informacionit.

3. Faqja e parë e kallëzimit drejtuar Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, datë 23.03.2021.

rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike nuk parashikohet në rastet specifike ligjore, sipas kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, Kolegji kryesisht vlerësoi se: a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

12.5 Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vlerësoi gjithashtu edhe nevojën e marrjes së këtyre provave në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, parë lidhur me zbatimin e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 dhe, pasi e gjeti të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në formën e gjykimit të zhvilluar në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit **Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit**

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Pavarësia tregon mungesën e paragjykimit apo anshmërisë, ekzistenca e paanshmërisë për qëllime të nenit 6 § 1 i KEDNj-së duhet të përcaktohet sipas: i) një testi subjektiv, ku duhet t'i kushtohet vëmendje nëse gjyqtari ka treguar ndonjë paragjykim apo anshmëri personale në një çështje të caktuar; dhe ii) një testi objektiv që do të thotë "duke përcaktuar nëse ndryshe nga sjellja personale e ndonjë prej anëtarëve të tij, vetë përbërja e gjykatës ka dhënë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim lidhur me anshmërinë e saj". Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka paragjykuar haptazi çështjen dhe ka marrë një vendim alogjik, mbi rezultate të paracaktuara, pa u bazuar në të dhënat e administruara. Në analizë të këtij shkakut ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

13.1 Nga procesverbali i seancës dëgjimore, rezulton se Komisioni i ka dhënë subjektit të gjitha mundësitë dhe garancitë për t'u mbrojtur, duke i dhënë të drejtën të paraqesë shpjegime dhe prova në lidhje me: i) vlerësimin e provave; ii) rezultatet e hetimit; dhe iii) kalimin e barrës së provës për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur kërkesa apo pretendime për konflikt të mundshëm interesi për anëtarët e trupit gjykues, të ketë kërkuar përjashtimin e ndonjë anëtari, apo që ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues të ketë kërkuar heqje dorë, gjë që mund të vinte në dyshim paanësinë e gjykimit dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, anëtarët e trupit gjykues kanë plotësuar deklaratat për mungesë konflikti interesi me subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 që parashikon detyrimin e institucioneve të rivlerësimit për të ushtruar funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

13.2 Në vlerësimin e elementit të paanësisë së gjyqtarit/komisionerit, duhet konsideruar edhe qëndrimi i mbajtur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe atë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas së cilave ekzistenca e paanësisë duhet të vlerësohet në bazë të dy kritereve, atij të vlerësimit subjektiv, tek i cili duhet të merret në konsideratë bindja personale dhe sjellja e gjyqtarit/komisionerit, domethënë nëse ky i fundit ka shfaqur ndonjë paragjykim apo

qasje personale, dhe atij të vlerësimit objektiv, sipas të cilit duhet siguruar nëse gjykata/komisioni në drejtim të përbërjes së saj ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanësinë e saj/tij.

13.3 Në kuadër të vlerësimit objektiv, është e nevojshme që të verifikohet nëse ekzistojnë fakte të cilat ngrenë dyshime mbi paanësinë e komisionerëve. Kjo nënkupton se, për të përcaktuar nëse në një çështje ka një arsye legjitime për t'u shqetësuar se një anëtar apo një trup gjykues tregon mungesë paanësie, këndvështrimi i personit të interesuar është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Vendimtare është nëse ky shqetësim i palës mund të justifikohet në mënyrë objektive. Sa i takon vlerësimit subjektiv, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "GjEDNj") i ka qëndruar vazhdimisht parimit se "paanësia personale e gjyqtarit duhet të merret e mirëqenë deri në momentin kur provohet e kundërta". Subjekti i rivlerësimit nuk identifikoi rrethana konkrete apo sjellje subjektive dhe qëndrime qortuese për anëtarët e Komisionit gjatë hetimit administrativ, si rrjedhojë shkaku i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

- 14.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se gjatë procesit të rivlerësimit është shkelur neni 6/1 i KEDNj-së për shkak se nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj. Pavarësisht se me ligj anëtarëve të organeve të rivlerësimit u njihet statusi i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë apo të Gjykatës Kushtetuese, kjo nuk do të thotë se ata janë gjyqtarë. Të gjitha aktet ndërkombëtare të cituara në këtë paragraf, të cilat synojnë të garantojnë pavarësinë e gjyqësorit, kur përcaktojnë se gjysma e organit që cakton masën disiplinore të shkarkimit të jenë gjyqtarë, e kanë fjalën për gjyqtarët apo magjistratët që në momentin e emërimit janë në sistemin gjyqësor dhe emërohen në organin e rivlerësimit nga vetë gjyqtarët apo prokurorët, dhe jo për persona që caktohen nga jashtë sistemit dhe u jepet statusi i gjyqtarit. Në analizë të këtij shkaku ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

14.1. Në lidhje me këtë shkaku ankimi, Kolegji vlerëson se pretendimi i ngritur lidhur me mospërmbushjen e kriterëve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të komisionerëve, tejkalon kompetencat juridiksionale të tij. Në kushtet që nuk konstatohen fakte apo rrethana të tjera në drejtim të mosformimit të rregullt të trupit gjykues, që do ta bënë vendimmarrjen e Komisionit të cënueshme në drejtim të pavarësisë apo paanësisë së saj, vlerësuar kjo në kuadër të rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe jurisprudenca e GjEDNj-së, pretendimi i subjektit nuk gjendet i bazuar në ligj.

14.2 Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se një pretendim i tillë për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar së fundmi edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin⁶ e saj lidhur me çështjen gjyqësore Xhoxhaj k. Shqipërisë ka arsyetuar: *[...] Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kriterëve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe*

⁶ Kolegji sjell në vëmendje që në datën e shpalljes së vendimit për subjektin e rivlerësimit Përparim Kulluri, vendimi i GjEDNj-së për çështjen Xhoxhaj k. Shqipërisë nuk ka marrë ende formë të prerë, referuar parashikimeve të nenit 44, pika 2 e KEDNj-së.

prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këta anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]. GjEDNj-ja në vijim ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar për rrjedhojë shkeljet të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se i është cenuar e drejta e parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së, për shkak se masa e dhënë nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Arsyet e dhëna nga organet e rivlerësimit nuk janë relevante dhe as të mjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë si shkarkimi nga detyra. Është e qartë se arsyet e dhëna nga Komisioni janë krejtësisht të pamjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë, si largimi i menjëhershëm nga detyra, pasi sanksionet disiplinore duhet të jenë proporcionale. Në analizë të këtij shkak ankimi, Kolegji arsyeton si më poshtë.

15.1 Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, Kolegji arsyeton se proporcionaliteti vlerësohet rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuar me njëri-tjetrin. Nga dispozitat ligjore të parashikuara nga Kushtetuta, por edhe nga ligji nr. 84/2016, vërehet se ato i referohen aplikimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit për zgjidhjen e çështjes në tërësi, duke synuar që në rastet objekt vlerësimi në kuadër të rivlerësimit të subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara. Në rastin e procesit të rivlerësimit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga organet e rivlerësimit, i çon këto organe drejt dhënies së një mase disiplinore e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë bazuar vetëm në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe në proporcion me shkeljet e konstatuara. Përpos referimit në analizën mbi proporcionalitetin e masës, kryer nga Gjykata Kushtetuese, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në dritën e qëllimit për të cilin është ngritur sistemi i rivlerësimit, ndalimi i ushtrimit të detyrave në sistemin e drejtësisë për 15 vjet, nuk është disproporcional, për sa kohë shteti legjitimohet të sanksionojë ndalime të caktuara në fusha të caktuara të funksioneve publike. Pretendimi i subjektit se ndalimi i zbatuar për të është disproporcional, bie ndesh edhe me kriteret e përcaktuara nga GjEDNj-ja në lidhje me ndalimin me ligj për individë të caktuar, për të kryer detyra të caktuara në sektorin publik. Sipas GjEDNj-së, në Niadin kundër Rumanisë:

[...] Funkionarët publikë, sidomos ata që si kërkuesi kërkojnë të shërbejnë në pozicione si ai që kërkuesi ka dashur të kthehet, ushtrojnë një pjesë të sovranitetit të shtetit. Ndalimi i kërkuesit, për pasojë, nuk është disproporcional kundrejt objektivit legjitim të shtetit për të siguruar besnikërinë e atyre që mbajnë përgjegjësitë që shoqërohen me interesin e përgjithshëm. 55. Gjykata vëren se shteti nuk ka vendosur ndalime mbi punësimin e ardhshëm të kërkuesit në sektorin privat apo edhe në kompani që paraqesin njëfarë interesi për shtetin në çështje

ekonomike [...]. Po ashtu, kërkuesit nuk i ndalohet punësimi në një fushë tjetër të sektorit publik, që nuk passjell/përfshin ushtrimin e funksioneve publike [...].

15.2 Në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor”. Po në nenin 4, pika 7, parashikohet: “E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit”. Në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të “Barra e provës”, parashikohet: Komisioni dhe Kolegji i Apelimit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit. Sipas dispozitave referuese, në vlerësimin e Kolegjit, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit orientojnë vlerësimin në tërësi të çështjes duke synuar që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit.

15.3 Nga analizimi dhe interpretimi i nenit 8 të KEDNj-së të lidhur me parimin e proporcionalitetit, në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ky parim është një nga tërësia e parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit, dhe nuk mund të merret si parim i veçuar për të mbuluar pasaktësitë në deklaratime të subjekteve të rivlerësimit që rezultojnë gjatë procesit të rivlerësimit. Si rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka gjykuar bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, pasi në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit, rëndësia e shkeljes e konstatuar është e tillë që nuk lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se vendimi i Komisionit nuk është logjik. Sipas fakteve të debatuar në seancën dëgjimore dhe nga vetë konkluzionet e Komisionit, pretendon ai, arrihet në përfundimin se z. Kulluri nuk ka pasur dijeni që shtetasi M. B. të ketë qenë i dënuar. Pavarësisht këtij fakti që vetë Komisioni konstaton, nga ana tjetër merr masë disiplinore ndaj subjektit pa analizuar elementet e anës subjektive. Në rastin konkret, vendimi i Komisionit është me të dhëna kontradiktore, ai është një akt i paligjshëm. Në analizë të këtij shkakut ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

15.4. Në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë jurisprudencën⁷ e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e cila thekson domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Kjo gjykatë ka vlerësuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Gjykata Kushtetuese arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjykata verifikon nëse vendimi i kundërshtuar

⁷ *Shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 24, datë 25.04.2016; nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese.*

është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërcituara.

15.5 Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi në paragrafin “vi” të faqes 9 ka cituar: *Lidhur me deklarin e subjektit se nuk ishte në dijeni se shtetasi A./M. B. ishte i proceduar penalisht nga Gjykata e Apelit Athinë për trafikimin e lëndëve narkotike, trupi gjykues vlerëson se edhe pse nga njëra anë është në përgjegjësinë e subjektit të tregojë kujdesin e shtuar për të siguruar marrëdhëniet e krijuara mbi përdorimin e automjetit, nga ana tjetër vlerëson se mosdijenja është relevante, në varësi të rrethanave dhe, për rrjedhojë, nuk mund ta rëndojë pozitën e tij.* Në një lexim të parë, ky paragraf duket kontradiktor me atë çfarë ka rezultuar dhe ka konkluduar në fund Komisioni për subjektin e rivlerësimit, por kjo mospërputhje në dukje, e pasqyruar në vendim, nuk është thelbësore për të cenuar standardin kushtetues të arsytimit të një vendimi gjyqësor. Sa më sipër, shkak i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar mjaftueshëm për të cenuar vendimin objekt shqyrtimi. Pjesa vijuese e vendimit sqaron përfundimisht arsytimin dhe qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për këtë çështje.

- 16.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka shkelur edhe parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, duke e trajtuar atë në mënyrë të diferencuar, pasi për situata të njëjta objektive me subjekte të tjera rivlerësuese, në rastin e tyre ka vendosur konfirmim në detyrë, ndërsa në rastin e ankuesit ka vendosur shkarkimin nga detyra. Subjekti pretendon se mbajtja e standardeve të njëjta të gjykimit është mjaft e rëndësishme, pasi është në thelb mbrojtje e parimit të sigurisë juridike.

16.1 Barazia në ligj dhe para ligjit, e trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektive të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, në vështrim të standardeve të nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kur ai [...] *nuk ka justifikim të arsyeshëm e objektiv*, pra kur ai nuk ndjek një “qëllim të ligjshëm” ose kur nuk ekziston marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. Gjykata Kushtetuese është shprehur në vendimet e saj se neni 18 i Kushtetutës, para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas të cilit shteti duhet të mos ndërhyjë, me qëllim që askush të mos diskriminohet padrejtësisht. Ky interpretim buron nga vetë natyra e parimit të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar në Kushtetutë, që nënkupton të drejtën për t’u trajtuar në mënyrë të barabartë, duke u mbrojtur nga diskriminime të pambështetura në një përligjje të arsyeshme dhe objektive.

16.2 Në lidhje me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, rezulton se nuk ka identifikuar se cilat janë vendimet që Komisioni ka mbajtur qëndrime të ndryshme për të njëjtën situatë, por ka sjellë në vëmendje rrethana në lidhje me raportin e DSIK-së ku shprehet se për faktet e pasqyruara në raportet e DSIK-së për rrethana më të rënda, Komisioni ka verifikuar informacionin dhe kur nuk ka gjetur prova të sakta, nuk e ka vlerësuar raportin e DSIK-së, në kundërshtim me sa ka ndodhur për subjektin e rivlerësimit. Në rastin objekt shqyrtimi, asnjëherë nuk mund të themi se jemi para së njëjtës situatë, pasi raportet e DSIK-së mund të jenë të deklasifikuara pjesërisht dhe informacioni që u ekspozohet subjekteve të rivlerësimit është i kufizuar, si rrjedhojë edhe në vendim është i pjesshëm për shkak të interesave konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajtjes sekret të metodave të policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt

të drejtave të palës në gjykim ose nevojave të tjera që diktohen dhe bëjnë të mundur moszbulimin e provave përkatëse, zbulimi i të cilave nuk është një e drejtë absolute për sa kohë prevalojnë interesa të tjerë. Si rrjedhojë, shkak i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës

17. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar dhe ka hartuar raportin fillestar me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, duke konkluduar mbi “Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Përparim Kulluri”. Komisioni i është drejtuar DSIK-së me shkresën nr. {***} prot., datë 19.11.2018, me anë të së cilës ka kërkuar përditësimin e raportit të cituar më sipër, të dërguar nga DSIK-ja. Kjo e fundit ka dërguar të njëjtin raport, por të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 18.12.2018, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (në vijim “KDZH”), sipas të cilit ka vlerësuar për papërshtatshmërinë për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.
18. Konkluzionet e Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës, janë: *Në përfundim, për sa i përket rezultatit të vlerësimit të figurës, trupi gjykues, për sa ka arsytuar, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit paraqet probleme serioze, pasi ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në bazë të shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, konkretisht me shtetasin M. B., i njohur edhe si A. B.*
19. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet shkaqeve të ankimit, ka pretenduar se Komisioni nuk ka administruar asnjë provë apo të dhënë të vlefshme, e cila të provojë faktin se shtetasi B. është i dënuar apo i përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu pretendon se në dosje është administruar raporti me "gjetjet" e përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nga i cili "rezulton" se shtetasi A. B. është i dënuar në Greqi, fakt i cili sipas subjektit të rivlerësimit është i pasqyruar vetëm në këtë "gjetje" dhe në asnjë dokument tjetër. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka asnjë provë që të vërtetojë faktin se shtetasi A. apo M. B. është proceduar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

19.1 Kolegji vëren se vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në mendimin e tij, përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 17.10.2019, bazuar në pikën 11 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, ka parashtruar se gjatë hetimit për efekt rivlerësimi të subjektit Përparim Kulluri, kanë rezultuar këto prova:

19.1.1 *Ka informacion se A. B., i njohur edhe si M. B., i lindur më {***}, ka qenë i proceduar penalisht në Greqi. Gjykata e Apelit e Athinës ka urdhëruar arrestimin e tij më 11.05.2006, për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike.*

19.1.2 *Gjithashtu, A. B., i njohur edhe si M. B., duke filluar nga data 24.01.2014, është hetuar penalisht për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike nga Prokuroria e Krimeve të Rënda të Shqipërisë, ku ka punuar subjekti i rivlerësimit nga muaji tetor i vitit 2013 e në vazhdim.*

19.1.3 *Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike dhe trafikimi i lëndëve narkotike përbëjnë vepra penale të “krimit të organizuar”, siç përcaktohet nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016.*

19.1.4 *Për pasojë, A. B., i njohur ndryshe edhe si M. B., është “person i përfshirë në krimin e organizuar”, në bazë të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, nga data 11.05.2006 e në vijim.*

19.1.5 Numri i telefonit {***}, i regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit, është përdorur shpesh gjatë periudhës 15.03.2008 deri më 04.02.2016, për t'i telefonuar numrit të telefonit {***}, i cili ka qenë i regjistruar në emrin e A. B., i njohur edhe si M. B.

19.1.6 Në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2013, nga të dhënat e sistemit TIMS, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar dhe ka kaluar kufirin shqiptar disa herë, duke drejtuar një autoveturë me nr. targe {***}. Kjo makinë rezultoi se në këtë periudhë ka qenë në pronësinë e M. B. (i njohur edhe si A. B.), nga viti 2010 deri në vitin 2014. Subjekti i rivlerësimit ka pranuar se e ka përdorur këtë makinë jo vetëm për të kaluar kufirin, por për qëllime të përgjithshme gjatë vitit 2012 dhe vitit 2013.

19.1.7 Në bazë të sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Përparim Kulluri ka pasur kontakt të papërshtatshëm me A. B., i njohur edhe si M. B., person i përfshirë në krimin e organizuar, në bazë të nenit 38, pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, si dhe nuk e ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi, siç duhet, formularin e vetëdeklarimit të kontrollit të figurës, në shkelje të nenit 38, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

19.2 Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit pasi është pyetur nga Komisioni në pyetësorin nr. 1, nëse ka përdorur pasuri në emër të dikujt tjetër në shtatë vitet e fundit, është përgjigjur shkurtimisht se ka përdorur mjetin me targë {***}. Kolegji vëren se Komisioni i ka dërguar shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRr”) me nr. {***} prot., datë 07.10.2019, ku kërkon informacion si dhe dosjen e plotë që i përket automjetit Volkswagen me targë {***} (vit prodhimi 2008). DPSHTRr-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 08.10.2019, ka dërguar në Komision bashkëlidhur dosjen e plotë që i përket këtij mjeti. Në këtë praktikë rezultoi se sipas faturës (dokument në gjuhën gjermane i përkthyer në shqip) me nr. {***}, datë 08.06.2010, lëshuar nga koncesionari “{***}”, shtetasi A. B. ka blerë këtë automjet me vlerë 18.067 euro që ka rezultuar në pronësi të tij deri në muajin prill 2014 dhe më pas i është shitur shtetasit M. D. me kontratën e shitjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 02.04.2014. Po në këtë praktikë, rezultoi se administruar edhe shkresa e cila konfirmon se shtetasi A. B. ka ndryshuar emrin e tij nga A. në M., sipas vendimit nr. {***}, datë 06.11.2009, të Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë nr. 5, Tiranë. Ky ndryshim i emrit të z. B. është konfirmuar edhe me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile nr. {***} prot., datë 04.10.2019. Po ashtu, edhe nga aksesimi i Komisionit në sistemin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “AMF”), ka rezultuar se ky automjet në periudhën e përdorimit, në vitin 2012, nga subjekti i rivlerësimit ka qenë në pronësi të shtetasit M./A. B.

19.3 Kolegji vëren se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për sqarimin e rrethanave të përdorimit të shpeshtë gjatë vitit 2012 të automjetit me targë {***}, me pronar z. M. B., i njohur edhe si A. B., person i përfshirë në krimin e organizuar, konkretisht në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 28.10.2019, të dhëna për rezultatet e hetimit administrativ, ka sqaruar se: [...] nuk e kam mohuar të kem përdorur automjetin në fjalë, por vazhdoj ta përsëris se atë ia kam marrë shtetasit M. D. Ai më ka thënë se e kishte të një shoku të tij, se i kishte bërë disa shërbime. Unë nuk mund ta merrja me mend se kush ishte shoku i tij apo që ai paska qenë A. dhe që tani njihet si M. [...]. Në përfundim të shpjegimeve, deklaroj se nuk jam takuar ndonjëherë me shtetasin A. B. që nga viti 1990. Nuk kam qenë në dijeni të faktit se ai apo vëllai im janë të përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu deklaroj se nuk kam pasur dijeni se ai mund të ketë qenë i dënuar në Greqi. Deklaroj se formularin e vetëdeklarimit për kontrollin e

figurës, parashikuar në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, e kam plotësuar saktë, pasi nuk kam qenë në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar.

19.4 Në vijim të rrethanave të cituara më sipër, Kolegji konstaton se në nenin 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, si mjet për kërkimin e provës parashikohet: *Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta. Mendimi mund të ndikojë në vendimmarrjen e Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit, por nuk ka vlerën e provës.* Në kuptim të këtij parashikimi ligjor, vëzhguesi ndërkombëtar ka dhënë një mendim në lidhje me një rrethanë të caktuar, siç është në rastin konkret vendimi i dhënë në Greqi nga Gjykata e Apelit e Athinës për arrestimin e shtetasit A. M. B., për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike. Kjo e dhënë e bërë me dije edhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, mbetet në kuadrin e informacioneve të besueshme, të cilat pavarësisht se nuk kanë vlerën e provës siç parashikon neni 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, nga Komisioni janë pranuar, gjë e cila ka sjellë një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit, e cila ka ndikuar në vendimmarrjen e Komisionit. Në paragrafët më sipër, por edhe në analizë të shkaqeve të tjera të ankimit në vijim, renditen disa pika takimi të rrethanave faktike që dëshmojnë për kontakte të subjektit të rivlerësimit me shtetasin A./M. B., të cilat krijojnë bindjen se nuk janë të rastësishme dhe të ndodhura në kushtet e padijenisë së subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, shkaku ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet bindës dhe i bazuar.

- 20.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ, nuk ka asnjë të dhënë që të provojë faktin se ka pasur kontakt me shtetasin A./M. B.. Ai ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se ka përdorur automjetin me targë {***}, por këtë automjet ia ka dhënë në përdorim shtetasi M. D. dhe jo shtetasi M. B.. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kërkesa e Komisionit, drejtuar kompanisë celulare “Vodafone”, për administrimin e tabulateve telefonike është një veprim i kundërligjshëm, por pavarësisht këtij fakti, nuk është vërtetuar se ka pasur komunikime me shtetasin M. B.

20.1 Në lidhje me këtë shkak ankimi, Kolegji vëren se nga të dhënat e sistemit TIMS të administruara nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, ka udhëtuar disa herë jashtë vendit nga pika kufitare e Hanit të Hotit dhe Muriqanit, në vendin e drejtuesit, me automjetin me targë {***}. Në këtë kohë, subjekti i rivlerësimit ushtronte funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Shkodër. Duhet theksuar se subjekti i rivlerësimit gjatë kësaj periudhe ka përdorur automjetin e A./M. B. (sipas dokumentacionit zyrtar, cituar në paragrafin 19.2 më sipër), pasi ky i fundit ka gëzuar pronësinë e këtij automjeti në periudhën 2010-2014, pastaj ia ka shitur M. D. më datë 02.04.2014. Në përgjigjet e rezultateve të hetimit, datë 28.10.2019, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë fakt, ka sqaruar se: *[...] unë nuk e kam mohuar të kem përdorur automjetin në fjalë, por vazhdoj ta përsëris se atë ia kam marrë shtetasit M. D. Ai më ka thënë se e kishte të një shoku të tij, se i kishte bërë disa shërbime. Unë nuk mund ta merrja me mend se kush ishte shoku i tij apo që ai paska qenë A. dhe që tani njihet si M.* Kolegji vëren se nga përgjigjet gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se subjekti i rivlerësimit, duke mos qenë shterues në përgjigje, fillimisht ka deklaruar se e ka përdorur këtë automjet në një periudhë brenda shtatë viteve të fundit dhe më pas deklaroi se këtë automjet ia ka marrë z. M. D., duke shpjeguar se nuk mund ta merrte me mend se i kujt ishte automjeti. Këto qëndrime në deklarime të subjektit të rivlerësimit, për Kolegjin në funksion edhe të shkaqeve të ankimit, nuk janë bindëse pasi bëhet fjalë për një subjekt që i nënshtrohet kontrollit për shkak të pastërtisë së figurës dhe integritetit, i cili është i detyruar të tregojë kujdes të shtuar në marrëdhëniet e krijuara mbi përdorimin e automjetit. Për

Kolegjin, nga rrethanat e rezultuara gjatë shqyrtimit të çështjes, subjekti i rivlerësimit i kishte mundësitë dhe aftësitë të kuptonte dhe të vihej në dijeni se i kujt ishte automjeti. Dokumentacioni i rregullt i automjetit në fjalë u është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit autoriteteve përkatëse në pikat kufitare ku ka kaluar dhe nuk mund të mendohet se ky dokumentacion i ka shpëtuar vëmendjes dhe leximit nga subjekti i rivlerësimit. Pasja apo posedimi i këtyre dokumenteve tregojnë për mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të ardhur në kontakt me përmbajtjen e tyre dhe të dhënave të hedhura në to. Këto rrethana çojnë në përfundimin se në periudhën që subjekti i rivlerësimit ka përdorur këtë automjet, duke iu referuar dokumentacionit dhe periudhave të gëzimit të së drejtës së pronësisë së automjetit, rezulton që subjekti i rivlerësimit, duke e ditur, e ka përdorur këtë automjet në kohën kur ishte në pronësi të shtetasit A./M. B.

20.2 Kolegjit i rezulton se gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision deklaraten e shtetasit M. D., të hartuar para noterit më datë 25.10.2019. Nëpërmjet këtij dokumenti, ky shtetas ka deklaruar: *Mjeti Volkswagen, me targa {***}, është lënë në servis tim nga z. M. B. për të kryer disa shërbime, të cilat ai do t'i likuidonte më pas. M. B. është klient i imi, pasi çdo shërbim për automjetet e ka kryer në servis tim. Theksoj se automjetin e përshkruar më sipër, gjatë periudhës kohore 2012 – 2013, ia kam lënë për ta përdorur në mirëbesim disa herë z. Përparim Kulluri, i cili është miku im. Në pritje të pagesës për shërbime të kryera automjetit, duke qenë se M. B. nuk po më likuidonte, ramë dakord që unë t'ia blija këtë mjet, duke i zbritur shërbimet të cilat i kisha kryer. Kontrata e shitblerjes së automjetit është nënshkruar me datë 02.04.2014.* Duke u nisur nga rrethanat të cilat deklaroi z. D. nëpërmjet deklaratës noteriale, ky i fundit e ka pasur automjetin rreth dy vite në servis, pa e specifikuar se çfarë problemesh teknike ka pasur automjeti që ka qëndruar kaq gjatë për t'u riparuar, automjet të cilin ka pasur mundësi ta japë lirisht në përdorim, edhe pse pronari i saj e ka dërguar për ta riparuar. Ndërkohë që rezulton e provuar se gjatë kësaj periudhe dyvjeçare, automjeti ka qenë në gjendje të rregullt teknike, pasi ka qarkulluar rregullisht edhe ndërmjet pikave kufitare të shteteve Shqipëri - Mali i Zi. Fakte këto që hedhin poshtë deklaratimet e shtetasit M. D., të bëra para noterit më datë 25.10.2019. Gjithsesi, lidhur me deklaratën noteriale, Kolegji mban në konsideratë qëndrimet⁸ që ka mbajtur në çështje të ndryshme, sipas të cilave megjithëse nuk është e pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, ajo nuk ka fuqi provuese në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështetet nga rrethanat dhe nga provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në këtë proces.

20.3 Kolegji vëren se Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 17.09.2019, i ka kërkuar kompanisë celulare “Vodafone” konfirmimin e identitetit që i përket numri i celularit {***}, numër i identifikuar edhe në informacionin e vëzhguesit ndërkombëtar. Kjo kompani, nëpërmjet shkresës me referencë {***}, datë 20.09.2019, ka konfirmuar se ky numër celulari ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit, nga data 15.03.2008 deri në datën 04.02.2016, por nuk ka administruar tabulatet telefonike siç ka pretenduar subjekti i rivlerësimit. Bashkëngjitur shkresës, kompania “Vodafone” ka dërguar edhe një CD, nga aksesimi i së cilës në informacionin që

⁸ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018(JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019(JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019(JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2; nr. 23/2020(JR), datë 25.09.2020, paragrafi 26.2.

përmban, nuk mund të konkludohet nëse subjekti i rivlerësimit e ka përdorur numrin e tij të telefonisë së lëvizshme për të komunikuar me A./M. B. Gjithsesi, rrethanat e tjera të rezultuara nga dokumentacioni i administruar në dosje, si dhe qëndrimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit gjatë pyetjes për gjetjet e Komisionit, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte me shtetasin A. M. B., për sa kohë ka përdorur automjetin e tij disa herë për të udhëtuar jashtë territorit të Shqipërisë gjatë periudhës që ky i fundit e ka pasur në pronësi të tij. Sa më sipër, shkak i ankimit i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

21. Subjekti i rivlerësimit pretendon se duhet të ekzistojë dijenia e subjektit që një person i caktuar është i përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu, duhet të provohet me prova të plota dhe objektive që subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni për ekzistencën e këtyre vendimeve, që një person është i dënuar për krim të organizuar dhe pavarësisht kësaj ai vazhdon të ketë kontakte. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, edhe sikur të merret i mirëqenë për një moment fakti se shtetasi M. B. është dënuar për një nga veprat penale të klasifikuara të krimi i organizuar, nuk ka pasur asnjë dijeni për këtë fakt dhe aktet e administruara gjatë hetimit administrativ vërtetojnë deklaratën e tij. Nga analiza në tërësi e fakteve të sipërcituara, arrihet në konkluzionin, sipas subjektit të rivlerësimit, se nuk ka pasur kontakte me shtetasin M. B., nuk vërtetohet që ai të jetë i përfshirë në krimin e organizuar, por më e rëndësishmja është se nuk ka dijeni nëse ai është i dënuar apo i përfshirë në krimin e organizuar. Në analizë të këtij shkak ankimi, rezultoi si më poshtë.

21.1 Kolegji vëren se në raportin e DSIK-së, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit rezultoi me vlerësimin për papërshtatshmëri në vijimin e detyrës, është konstatuar se: *Për subjektin e rivlerësimit administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.* Institucionet verifikuese (shkruhet në raport, pjesa e deklasifikuar) kanë informuar se: *“Pas verifikimeve të kryera rezulton se disponohen të dhëna ku subjekti i rivlerësimit gjatë vitit 2012 dhe 2014 ka pasur kontakte të papërshtatshme/jorastësore. Disa nga këto kontakte, z. Kulluri i ka pasur edhe nëpërmjet vëllait të tij, shtetasit E. K. Nga vlerësimi i informacioneve të siguruar nga institucionet verifikuese për subjektin e rivlerësimit dhe në zbatim të kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, neni 37, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, neni 38, pika 4, shkronja “b”, “c”, “ç” dhe “d”, pika 6, shkronjat “a” dhe “b”, bazuar në këto informacione për subjektin e rivlerësimit merret në konsideratë aktualiteti i të dhënës që evidenton rrethanat e konstatimit të faktit se z. Përparim Kulluri ka pasur kontakte të papërshtatshme jorastësore për një periudhë relativisht të gjatë kohe. Gjithashtu ekziston një kontakt i papërshtatshëm me person/persona (vëllai i subjektit të rivlerësimit) të përfshirë në krimin e organizuar (neni 38, pika 4, shkronjat “b”, “ç” dhe “d”, pika 6, shkronjat “a” dhe “b”). Informacionet e përfuturara nga autoritetet verifikuese e bëjnë subjektin një individ me tendencë për përfshirje në veprimtari kriminale dhe që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale. Ky raport mbyllet duke konstatuar papërshtatshmërinë në vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Përparim Kulluri.*

21.2 Kolegji konstaton se në bazë të këtyre informacioneve që disponohen, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, nenin Ç, pika 5 dhe nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit pasi dukej se kishte pasur kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, konkretisht me z. M. B., çka vërtetohej me përdorimin e shpeshtë gjatë vitit 2012 të automjetit të këtij të fundit me targa {***}. Gjithashtu, në formularin e vetëdeklarimit për figurën (shtojca 3 e ligjit 84/2016), nuk ishin respektuar

kërkesat ligjore nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk kishte deklaruar kontaktin e papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

21.3 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dërguara në Komision më datë 28.10.2019 mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka sqaruar lidhur me këto fakte se: *Po, e njoh shtetasin A. B. Me këtë shtetas kemi qenë studentë në vitin 1990, kur unë studioja në vitin e parë të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, Dega Filozofi dhe ai në Fakultetin e Histori-Filologjisë. Ne banonim në Qytetin Studenti në godinën nr. {***}, në të njëjtin kat dhe në dhoma përbri dhe që nga ai vit nuk e kam takuar më. Vetëm tani, pasi mora dosjen e KPK-së, po e mësoj që paskemi lindur të dy në të njëjtin muaj të të njëjtit vit, si dhe që ai paska ndërruar dhe emrin dhe tani quhet M. [...]. Megjithatë, dua të di nëse kontrolli është bazuar në prova të sakta, në informacione të marra në mënyrën e duhur ligjore, apo është kryer në bazë të hamendësimeve dhe informacioneve të pakonfirmuara e të paplota. Në këto raporte del se unë paskam pasur kontakt të papërshtatshëm sipas parashikimeve të nenit 38, pika 4, shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, por pa përcaktuar se kur është koha, forma dhe personat me të cilët është konsumuar secili prej këtyre kontakteve [...]. Sa u përket gjetjeve nga Operacioni Ndërkombëtar, kam për të shpjeguar se nuk jam në dijeni se shtetasi A. B. ka qenë i proceduar penalisht në Greqi për veprën penale prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike. Nuk kam nga ta dija nëse ka jetuar në Greqi, është ndjekur penalisht, apo dënuar në atë vend. [...] Nga ana tjetër, unë nuk e kam mohuar të kem përdorur automjetin në fjalë, por vazhdoj ta përsëris se atë ia kam marrë shtetasit M. D. Ai më ka thënë se e kishte të një shoku të tij se i kishte bërë disa shërbime. Unë nuk mund ta merrja me mend se kush ishte shoku i tij apo që ai paska qenë A. dhe që tani njihet si M.*

21.4 Në parashtrimet e datës 26.03.2021, të sjella në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka shprehur se vetë relatorja e çështjes në Komision ka marrë nga Prokuroria për Krime të Rënda një shkresë me nr. {***}, datë 03.07.2019, e cila jo vetëm nuk e konfirmon këtë gjetje, por shprehet zyrtarisht për të kundërtën. Në këtë shkresë shkruhet tekstualisht: *Në regjistrin e njoftimit të veprave penale të kësaj Prokurorie, nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal ndaj shtetasit M/A.B.* Subjekti i rivlerësimit shprehet në parashtrime se relatorja, me dashje shkruan në raportin përfundimtar, si edhe në vendim një rrethanë që nuk ekziston në dokumentin zyrtar në të cilin ajo referohet. Subjekti i rivlerësimit parashtron se në seancën publike këtë rrethanë ia ka vënë në dukje relatores dhe anëtarëve të Komisionit në mënyrë të tillë që të reflektonin dhe të mos ia përfshinin në vendim.

21.5 Në analizë të rrethanave dhe mendimit të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, rezultojnë se Gjykata e Apelit në Greqi ka urdhëruar arrestimin e shtetasit A. B. për veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, për pasojë ai konsiderohet nga ligji si person i përfshirë në krimin e organizuar për efekt të këtij procesi.

21.6 Kolegji, në vlerësimin e rrethanave faktike si më sipër, ka parasysh se objekt i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 përkufizon që, në kuptim të këtij ligji, konsiderohet si person që është përfshirë në krimin e organizuar: “[...] Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person i cili është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim “ligji nr. 10192/2009”),

i ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet [...]”. Duke qenë se vepra penale për të cilën është proceduar M. B., përfshihet në nenin 3, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 10192/2009, në mbështetje edhe të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, M. B. përbën kontakt të papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit për shkak se procedimi penal nëpërmjet të cilit janë zhvilluar hetime në ngarkim të tij e bën atë “person të përfshirë në krimin e organizuar”.

21.7 Kolegji vëren se nga të gjitha rrethanat e mësipërme, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mungesë dijenie të veprimtarisë kriminale të A. M. B. nuk janë bindëse. Së pari, ky shpjegim nuk përputhet me deklaratimet e tij në pyetësorin standard, ku ai është shprehur se ka përdorur automjetet të personave të njohur prej tij. Së dyti, në vitin 2012, subjekti ka përdorur shumë shpesh automjetin e një individi të cilin e ka njohur më parë, të paktën nga mbiemri, sipas deklaratimeve në shpjegimet e rezultateve të hetimit. Shtetasi A./M. B. rezultojnë të jetë person me precedentë penalë për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, në Greqi, sipas mendimit të referuar nga vëzhguesi ndërkombëtar, si rrjedhojë përbën kontakt të papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit në kuptim të nenit 3, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, si dhe procedimi penal që provon se në ngarkim të tij zhvillohen hetime e bën atë “person të përfshirë në krimin e organizuar”, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, Kolegji konstaton se bazuar në “Vërtetimin e gjendjes gjyqësore” nr. {***} prot., datë 02.10.2019, që i përket shtetasit M. B., të administruar në dosjen e Komisionit, rezultojnë se ky individ, me vendimin nr. {***}, datë 20.01.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është deklaruar fajtor për veprën penale të “Vrasjes me dashje në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 76 dhe 25 të Kodit Penal, si dhe të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2, i cili është dënuar me 25 vjet burg, vendim i cili është prishur me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2006, të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke vendosur pushimin e çështjes. Po ashtu, në bazë të vendimit nr. {***}, datë 09.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, M. B. është deklaruar fajtor për veprën penale “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe është dënuar me 2 muaj burg. Për të gjitha rrethanat e cituara më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me kontaktin me shtetasin A. M. B., si person me precedentë penalë në llojin e veprave të cilat përfshihen në krimin e organizuar, nuk është bindës dhe, si rrjedhojë, shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

21.8 Përveç sa më sipër analizuar, bazuar në jurisprudencën⁹ e Kolegjit, si dhe në informacionet dhe dokumentacionet e klasifikuara, të cilat nuk mund të përdoren në aktet publike apo të vihen në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, me përjashtim të pjesëve të deklasifikuara me të cilat është njohur dhe rezultojnë me kontakte jorastësore me persona të përfshirë në krimin e organizuar, është mbajtur në konsideratë edhe qëndrimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në vendimin në Regner kundër Republikës Çeke, është shprehur: *Duke pasur parasysh gjykimin në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe marzhin e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e brendshme, kufizimet që veprojnë mbi gëzimin e të drejtave nga kërkuesi, të dhëna atij në pajtim me parimet e gjyqimit bazuar në parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, ishin balancuar në një mënyrë të tillë që një balancë e drejtë ndërmjet palëve nuk ishte cenuar në mënyrë të tillë që të cenonte thelbin e së drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë.*

⁹ Vendimi nr. 20/2020 (JR), datë 08.09.2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paragrafi 29.1.

[...] e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim [...]. Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuetit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t'u përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë [...].

21.9 Në konkluzion të analizës së tij, Kolegji krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, pikërisht për shkak të pasjes së kontaktit të papërshtatshëm, si pasojë e njohjes me personin e përfshirë në krimin e organizuar, shtetasin A.M. B., fakt ky që prezumon vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe subjekti i rivlerësimit, megjithëse i gjendur në këtë situatë, nuk arriti të provojë të kundërtën e këtij fakti apo të sjellë argumente bindëse dhe ligjore që do e zhvishnin atë nga kjo përgjegjësi. Në vijim të arsyetimit të kësaj situatë faktike, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit, për shkak të kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me nenin Dh, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezultoi me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, çka e bën të pamundur vazhdimin e detyrës prej subjektit të rivlerësimit.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë

- 22.** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me kontrollin e pasurisë, ka pretenduar në ankim se konkluzioni i pasqyruar nga Komisioni nuk është i vërtetë sepse, sipas tij, nuk ka paraqitur asnjë dokument fiktiv. E ardhura nga shpronësimi është përfituar bazuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe, si rrjedhojë, Komisioni nuk ka kompetencë të vlerësojë ligjshmërinë e këtij vendimi. Në kërkesën drejtuar Bashkisë {***}, subjekti i rivlerësimit pretendon se shënohet qartësisht se kërkon shpronësimin e dyqanit me sipërfaqe 65,2 m². Sipas tij, kjo e dhënë vërteton plotësisht faktin se nuk ka pasur qëllim që të kërkonte shpronësim për një sipërfaqe më të madhe. Konkluzioni i arritur nga Komisioni që ka ushtruar ndikimin si prokuror, është thjesht një fakt i sajuar, i pambështetur në asnjë të dhënë ose provë të administruar gjatë hetimit administrativ, por i sajuar për të arritur në një vendim të paragjykuar. Në analizë të këtij shkak ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

22.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, duke paraqitur të dhëna të pavërteta, me qëllim sigurimin e vlerës së lartë të përfitimit të të ardhurave nga shpronësimi i objektit “dyqan”, duke pasur parasysh pozicionin e tij si prokuror, cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

22.2 Në Deklaratën e Interesave Privatë Periodikë (në vijim “DIPP”) të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë “Dyqan tregtie për artikuj industrialë, me sipërfaqe 30 m², i ndërtuar prej vitit 1994, në {***}, Vlorë, me vlerë 600.000 lekë. Burim krijimi: I ndërtuar prej meje në vitin 1994. I dhënë me qira në masën 6000 lekë në muaj. Me të ardhura nga emigracioni, si dhe kursimet familjare”.

22.3 Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: “Dyqani në pronësinë time është prishur për interes publik ({***}, Vlorë). Në pritje të kompensimit”.

22.4 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shpronësimi publik sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (në vijim “VKM”) nr. {***}, datë 19.03.2014, në shumën 7.781,000 lekë, vlerë të cilën subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar të marrë në katër këste përkatësisht 3.000.000 lekë; 2.000.000 lekë; 2.388.838 lekë dhe 392.162 lekë.

22.5 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, subjekti i rivlerësimit, me shkresën e datës 15.02.2010, i ka kërkuar Bashkisë {***} të përshpejtohet procedura e shpronësimit për objektin me sipërfaqe 65 m² në pronësi të tij, të prekur nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i Shëtitorës Orikum”. Bashkia {***}, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.03.2010, drejtuar subjektit të rivlerësimit, i ka kthyer përgjigje, në të cilën ka cituar se nga ana e saj janë marrë të gjitha masat për të nisur procedurën e shpronësimit për të gjithë personat të cilët ishin cenuar nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i Shëtitorës Orikum”. Kjo bashki i kishte kërkuar ZVRPP-së Vlorë konfirmimin zyrtar të pronësisë së subjektit të rivlerësimit, përgjigjja e së cilës nuk i është kthyer. Gjithashtu Bashkia {***}, po sipas kësaj shkrese, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit vërtetimin hipotekor të rifreskuar, të shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit të pasurisë, si dokumenti kryesor për plotësimin e dosjes së shpronësimit, por subjekti i rivlerësimit ka depozituar vetëm vërtetimin hipotekor të rifreskuar, pa e shoqëruar me hartën treguese, por vetëm me një plan rievimi, duke u bërë kështu pengesë për nisjen e procedurës së shpronësimit. Duke qenë se prona e kërkuar për shpronësim është objekt dhe, për pasojë, për këtë duhet domosdoshmërisht të jetë bërë një raport vlerësimi, kjo bashki nuk e disponon një të tillë, mungesa e të cilit përbën një pengesë serioze për nisjen e procedurës së shpronësimit, citohet në shkresë.

22.6 Kolegji konstaton se në të njëjtën shkresë të Bashkisë {***} drejtuar subjektit të rivlerësimit, cituar në paragrafin më sipër, thuhet se nga ana e subjektit është dorëzuar një raport vlerësimi i pasurisë, i përgatitur nga ing. A. D. më datë 10.07.2006, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit. Gjatë shqyrtimit të këtij raporti, Bashkia {***} ka vënë re disa mangësi, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë: (a) Prona objekt vlerësimi është ndërtuar këto katër vitet e fundit, ndërsa në vërtetimin hipotekor rezulton se pronësia e subjektit figuron e regjistruar më datë 27.11.1997, pra nëntë vite më parë nga momenti i bërjes së raportit të vlerësimit, si rrjedhojë pasuria nuk rezulton të jetë objekti që kërkohet të shpronësohet në përputhje me vërtetimin hipotekor të dorëzuar. (b) Pasuria, sipas raportit të vlerësimit, ka qenë dykatëshe, me sipërfaqe 130,4 m², ndërkohë që në vërtetimin e pronësisë së paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pronësia ka një sipërfaqe prej 65,2 m², gjë që sipas Bashkisë {***} nënkupton që kemi të bëjmë me dy objekte të ndryshme. (c) Raportit të vlerësimit nuk i është bashkëngjitur dokumenti që vërteton pronësinë mbi të cilën është bazuar eksperti për vlerësimin e saj dhe, për pasojë, raporti bëhet objektivisht i pavlefshëm; (d) Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar hartën treguese e cila pasqyron vendndodhjen e pronës si dhe mungesa e raportit të vlerësimit si dokument që nuk mund të ribëhet pasi objekti nuk ekziston më, pamundëson nisjen e procedurës së shpronësimit.

22.7 Kolegji vëren se duke u nisur nga mangësitë e cituara më sipër, në këtë arsyetim, Bashkia {***} nuk ka bërë shpronësimin e pasurisë, pasi ka krijuar bindjen se bëhet fjalë për dy objekte të ndryshme (65,2 m², sipas vërtetimit të pronësisë dhe 130,4 m², sipas raportit të vlerësuesit të pronës). Subjekti i rivlerësimit, në kushtet e refuzimit të shpronësimit nga Bashkia {***}, më datë 10.04.2010, ka ngritur padi në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt kundërshtimin e aktit administrativ nr. {***}, datë 12.03.2010 dhe detyrimin e Bashkisë {***} të shpronësojë objektin “dyqan” që është prekur nga ndërtimi i shëtitorës në {***}. Kjo gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2010, ka vendosur “Shfuqizimin e aktit administrativ të Bashkisë {***}, dhe detyrimin e kësaj të fundit për të vijuar procedurat e shpronësimit kundrejt vlerës prej

7.781.000 lekësh për pronën e paditësit (subjektit të rivlerësimit)”. Në arsyetimin e këtij vendimi, ndër të tjera, bëhet prezent një akt ekspertimi i përpiluar gjatë gjyqimit nga ekspertja vlerësuese e pasurisë së paluajtshme R. B., e cila e ka hartuar raportin për vlerësimin e sendit mbi bazën e metodës së krahasimit, për të nxjerrë vlerën reale të sendit në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Sipas këtij raporti të hartuar nga vlerësuesja e pronës e caktuar nga gjykata, dokumenti i cili ndodhet në dosjen e gjykatës së administruar nga Komisioni, rezulton se sendi i paluajtshëm i llojit dyqan, me sipërfaqe ndërtimore 65,2 m², ka vlerë 7.781.000 lekë.

22.8 Kolegji vëren se me VKM-në nr. 153, datë 19.03.2014, është miratuar në emër të subjektit të rivlerësimit shpronësimi publik për pasurinë “truall” (në një kohë që objekti i shpronësimit është dyqan) me sipërfaqe 65,2 m², në masën 7.781.000 lekë. Nga korrespondenca e Komisionit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, në dokumentet e administruara në dosje, rezulton procesverbali i datës 05.06.2013, i komisionit të ngritur pranë kësaj ministrie, i cili ka kryer verifikimin e dokumentacionit me qëllim përfitimin e shpërblimit të shpronësimit të objektit “dyqan” për subjektin e rivlerësimit, rezulton se pasuria që do të shpronësohet është specifikuar e llojit “tokë truall”, me sip. 65,2 m², bazuar në vendimin nr. {***}, datë 01.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga mospërputhjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ lidhur me cilësimin e kësaj pasurie herë truall e herë dyqan, Komisioni ka pyetur nëpërmjet pyetësorit nr. 6 subjektin e rivlerësimit, i cili në përgjigjet e datës 14.09.2019 ka sqaruar se: *Trualli mbi të cilin është ndërtuar dyqani, ka qenë shtetëror. Sheshi i ndërtimit është marrë me Vendim të Këshillit të Komunës {***}, nr. {***}, datë 23.07.1993, me lëndë “Dhënie shesh ndërtimi për lokal privat”, pasi në atë kohë nuk ekzistonte Këshilli i Rregullimit të Territorit i cili është krijuar me ligjin për urbanistikën në vitin 1998. Më pas i jam drejtuar gjykatës me padinë me objekt: Për njohjen pronar të ndërtimit në fjalë, ku gjykata me vendimin nr. {***}, datë 03.11.1997, ka detyruar Bashkinë {***} të më njihte pronar për dyqanin në fjalë. Me këtë vendim gjyqësor, i jam drejtuar zyrës së Hipotekës Vlorë, e cila e ka regjistruar dyqanin në pronësinë time me nr. {***}, datë 27.11.1997. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision vendimin nr. {***}, datë 03.11.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas të cilit, ashtu siç ka dhënë shpjegimet më sipër subjekti, e njuh atë pronar të pasurisë dyqan me sipërfaqe 65,2 m².*

22.9 Kolegji konstatoi se nga dokumentet që gjenden në dosje, rezulton i administruar vërtetimi mbi dokumentet hipotekore me nr. {***}, sipas të cilit është regjistruar më datë 27.11.1997 në favor të subjektit të rivlerësimit, pasuria “dyqan” me sip. 65,2 m², në zonën kadastrale {***}, me adresë {***}, Vlorë. Nga ky dokument rezulton se lloji i pasurisë është dyqan dhe jo truall, siç është shkruar në VKM-në 153, datë 19.03.2014, ku sipas të cilit mund të jemi para një gabimi material në cilësimin e llojit të pasurisë për të cilën po zhvilloheshin procedurat e shpronësimit. Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë dyqan me sipërfaqe 30 m², ndërsa në vërtetimin e pronësisë dyqani rezulton me sipërfaqe 65,2 m², si rrjedhojë jemi përpara një deklarimi të pasaktë të pasurisë në deklaratën periodike nga ana e subjektit të rivlerësimit.

22.10 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, i cili përmban edhe fashikullin e gjyqimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lidhur me procesin gjyqësor të zhvilluar nga kjo gjykatë për shpronësimin e dyqanit në pronësi të subjektit të rivlerësimit, rezulton se janë administruar nga gjykata dy raporte të ekspertëve të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme. I pari është hartuar nga vlerësuesi A. D., më datë 10.07.2006, me porositjen e subjektit të rivlerësimit me qëllim dorëzimin pranë Bashkisë {***} për procedurat e shpronësimit të objektit dyqan me sip. 65,2 m² (referuar vërtetimit nga dokumenti hipotekor). Ky raport është dorëzuar në Gjykatën e Vlorës si provë nga subjekti i rivlerësimit. Ndërsa raporti i dytë mban datën 22.11.2010, është hartuar nga eksperte vlerësuese R. B., e cila është caktuar nga

gjykata e Vlorës ku po gjykohej kërkesëpadia e subjektit të rivlerësimit për detyrimin e Bashkisë {***} për shpronësimin e objektit dyqan, në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Në momentin kur është kryer ky raport vlerësimi (2010), objekti nuk ishte ekzistues për shkak të shembjes për zbatimin e projektit për ndërtimin e shëtitorës {***}.

22.11 Kolegji konstaton se në raportin e parë të vlerësimit të pronës së subjektit, të hartuar në vitin 2006, sqarohet se vlerësimi është kryer mbi bazën e vlerës së investimit (kostos) të lirë mbi pronën e subjektit të rivlerësimit. Nga përshkrimi që i bën pronës në këtë raport, citohet se: *Godina është ndërtuar këto 4 vitet e fundit. Ajo është projektuar dhe ndërtuar me destinacion të përcaktuar mirë si një lokal shërbimi, në katin e parë përbëhet nga dy ambiente që përdoren për shitje të artikujve industrialë, ambientet e tualetit dhe kafazet e shkallëve. Prona është dykatëshe, me sipërfaqe të katit përdhe prej 65,2 m² dhe sipërfaqe të katit të dytë prej 65,2 m², duke bërë kështu sipërfaqe totale prej 130,4 m² [...] inspektimi është bërë nga ana sipërfaqësore, si dhe në katin përdhe. Ndërtesa në momentin e vlerësimit është në gjendje të mirë. Ky vlerësim shkruhet në raport, është bërë me metodën e kostos dhe vlera e plotë e investimit për këtë pronë të vlerësuar sipas kësaj metode, më datë 10.07.2006, është 3.719.268 lekë. Në fashikullin gjyqësor të kësaj çështjeje, të administruar në dosjen e Komisionit, gjenden edhe disa foto të objektit të cilat paraqesin një objekt dykatësh.*

22.12 Në këtë raport vlerësimi të ekspertit, vihet re e cituar një sipërfaqe ndërtimore më e madhe (130,4 m²) se ajo e pasqyruar në vërtetimin e pronësisë (65,2 m²) të pronës së subjektit të rivlerësimit. Në këtë pikë, na rezultojnë tri lloje sipërfaqesh për të njëjtën pronë (dyqan), ajo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit (30 m²) në DIPP-në e vitit 2003, sipërfaqja sipas vërtetimit të pronësisë (65,2 m²), si dhe sipërfaqja sipas raport-vlerësimit të parë që rezulton 2-fishi i kësaj të fundit (130,4 m²). Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me këto mospërputhje për llojin e pronës objekt shpronësimi, është pasqyruar në paragrafin 22.8 më sipër. Sqarohet se subjekti i rivlerësimit në shkresën e datës 15.02.2010, drejtuar Bashkisë {***} për përshpejtimin e procedurës së shpronësimit, ka referuar objektin me sipërfaqe 65 m². Po ashtu, edhe në kërkesë padinë e ngritur prej tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është referuar sipërfaqja e dyqanit 65,2 m².

22.13 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje nuk rezulton data e saktë e shembjes së objektit në pronësi të subjektit të rivlerësimit, por nga raporti i vitit 2006 del qartë se objekti ishte akoma ekzistues, pasi vlerësuesi e ka përshkruar me detaje në dy katet e tij. Lidhur me paqartësinë e sipërfaqes së rezultuar, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga anëtari i Komisionit në seancën e datës 04.11.2019, nëse objekti ishte një apo dykatësh, dhe subjekti i rivlerësimit ka saktësuar se objekti ishte dykatësh, me sipërfaqe 65 m². Pavarësisht sipërfaqes më të madhe të rezultuar në këtë raport, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar shpronësimin duke iu referuar dokumentit të pronësisë që disponon për këtë objekt, ndaj arsytimi i Komisionit se subjekti ka paraqitur të dhëna të rreme në Bashkinë {***} nuk gjen mbështetje nga dokumentacioni i administruar në dosje.

22.14 Kolegji vëren se në raportin e parë të vlerësimit (2006), sipas vlerësuesit të pasurisë së paluajtshme, ndërtimi i objektit është i para katër viteve, çka do të thotë se është ndërtuar në vitin 2002, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 6 të Komisionit, ka pretenduar se ndërtimi është bërë në vitin 1994, duke cituar se: *Sheshi i ndërtimit është marrë me vendim të Këshillit të Komunës {***}, nr. {***}, datë 23.07.1993, me lëndë “Dhënie Shesh Ndërtimi për lokal privat”, pasi në atë kohë nuk ekzistonte Këshilli i Rregullimit të Territorit i cili është krijuar me ligjin për Urbanistikën në vitin 1998. Më pas i jam drejtuar gjykatës me*

*padinë me objekt: Për njohjen pronar të ndërtimit në fjalë, ku gjykata me vendimin nr. {***}, datë 03.11.1997, ka detyruar Bashkinë {***} të më njëhte pronar për dyqanin në fjalë. Me këtë vendim gjyqësor i jam drejtuar zyrës së Hipotekës Vlorë, e cila e ka regjistruar dyqanin në pronësinë time me nr. {***}, datë 27.11.1997. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, gjendet edhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. {***}, datë 03.11.1997, sipas të cilit është vendosur pranimi i padisë së subjektit të rivlerësimit dhe njohja e tij pronar i objektit të ndërtuar, me sip. 65,2 m², duke bërë edhe përshkrimin e ndërtesës dhe sipas të cilit është bërë edhe regjistrimi i tij në ZVRPP, çka krijon bindjen se dyqani në këtë kohë (1997) ishte i ndërtuar.*

22.15 Kolegji konstaton se në raportin me vlerësimin e dytë të ekspertes R. B., hartimi i të cilit është kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili mban datën 22.11.2010, është përshkruar se objekti nuk është faktik dhe vlerësimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit të ndodhur në dosjen gjyqësore. Pra, objekti tashmë është shembur dhe ky raport është bërë mbi bazë dokumentesh që janë fotot e objektit, si dhe dokumenti i pronësisë. Këtij raporti i janë bashkëngjitur edhe fotografi të cilat në pamje të parë duken të njëjta me ato të cilat ka disponuar vlerësuesi i parë z. D. në raportin e hartuar prej tij në vitin 2006. Nuk është i qartë fakti se përse në raportin e znj. B. prona referohet si kat përdhe me sipërfaqe 65,2 m², e ndodhur në {***}, Vlorë, në një kohë që fotot janë të njëjta dhe pasqyrojnë një objekt dykatësh. Në përfundim, në konkluzionet e këtij raporti, ekspertja ka vlerësuar se në datën 22.11.2010, prona me sipërfaqe 65 m², në {***}, Vlorë ka vlerën e tregut të lirë prej 7.781.000 lekësh.

22.16 Kolegji vëren se mbi bazën e këtij raporti ka vendosur edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke përcaktuar në vendim vlerën e objektit sipas raport-vlerësimit të pronës objekt shpronësimi, duke shfuqizuar aktin administrativ me nr. {***}, datë 12.03.2010, të Bashkisë {***}, si dhe duke e detyruar këtë bashki të vazhdojë procedurat për shpronësimin e subjektit të rivlerësimit kundrejt vlerës së sendit 7.781.000 lekë, si dhe përcjelljen e kërkesës për shpronësim Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 153, datë 19.03.2014, ka miratuar në emër të subjektit të rivlerësimit shpronësimin për interes publik për pasurinë e tij, me vlerën e përcaktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë të sipërcituar.

22.17 Kolegji vlerëson nga analiza më sipër, se nga tërësia e dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe nga rrethanat e faktet që dolën gjatë kësaj analize, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ofruar të dhëna të pavërteta lidhur me këtë pasuri, siç ka konkluduar Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, pasi procedura e shpronësimit është ndjekur duke u bazuar në vërtetimin mbi dokumentin hipotekor, i cili e pasqyron pasurinë të regjistruar me sip. 65 m², bazuar në raportin e vlerësimit të ekspertit të caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas të cilit është përcaktuar vlera e sendit objekt shpronësimi në masën 7.781.000 lekë, si dhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pasaktësia që lidhet me vullnetin e subjektit të rivlerësimit rezulton në DIPP-në e vitit 2003, ku subjekti e ka deklaruar sipërfaqen e këtij dyqani 30 m² nga 65,2 m² që rezulton sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor, duke e bërë të pavërtetë këtë deklaram, dhe me këtë sipërfaqe është trajtuar edhe në gjithë procedurën e shpronësimit, përfshirë edhe procesin gjyqësor. Duke pasur në konsideratë faktin që shpronësimi është kryer mbi bazën e sipërfaqes sipas dokumentacionit, pavarësisht nga mangësitë e konstatuara në deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e vitit 2003, Kolegji çmon se referuar vlerës provuese që kanë deklaratat periodike të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe problematikave të konstatuara në këtë rast, kjo çështje të mos renditet në grupin e pasaktësive që të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi.

23. *Në lidhje me pasurinë automjet tip “Volkswagen”, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur një shkak të veçantë ankimi në lidhje me këtë pasuri, por në ankimin e paraqitur prej tij (shih faqen 4 paragrafi 11 i ankimit) citon: Dua të theksoj që në fillim të kësaj analize se konkluzionet e arritura nga KPK, të cilat kanë shërbyer si “shkaqe” për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit, nuk janë rrjedhojë e analizës së provave të administruara gjatë hetimit administrativ, por vetëm “gjetje” të sajura për të arritur në një rezultat të paracaktuar. Për këtë arsye, u krye një analizë financiare vetëm për pasurinë automjet tip “Volkswagen”, i cili nga vendimi i Komisionit ka qenë edhe një nga shkaqet e shkarkimit.*

23.1 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në deklaratën vetting subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Makinë tip “Volkswagen”, blerë nga shoqëria “Classic” ShPK sipas faturës së shitjes me vlerë 21.600 euro, me burim krijimi shitje makine “Volkswagen Polo”, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.02.2012, pakësim depozite me afat të datës 18.03.2011 në Raiffeisen Bank, si dhe kalim nga llogaria rrjedhëse te paga.

Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shitje e makinës së blerë më datë 01.04.2010, me çmim 12000 euro”, “pakësuar depozita në Raiffeisen Bank e datës 18.03.2011, 1.684.300 lekë”, “Blerje makine (shitje e makinës, pakësim depozite, pagat e vitit 2012) [...] 21600 euro”.

23.2 Në përgjigjet që ka dërguar subjekti i rivlerësimit në Komision për rezultatet e hetimit, në lidhje me këtë çështje është shprehur: *Ashtu sikur ju kam bërë me dije në pyetësor (trajtuar dhe nga ana Juaj) për kryerjen e shitjes së makinës “Volkswagen Polo,, me prokurën e posaçme nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 24.11.2011, kam autorizuar shtetasin D. Gj., në cilësinë e agjentit të shitjes. Në vijim, shtetasi D. Gj. ka disponuar mjetin, ka gjetur blerësin, ka negociuar çmimin në vlerën 12.000 euro, shumë e cila na është dorëzuar dorazi, po nga D. Gj., në datën 25.01.2012, duke mbajtur nga shuma 12.000 euro shumën 5.000 euro në formën e kaparit për blerjen e një automjeti të ri pranë kompanisë Classic Volkswagen”. Në vendimin e Komisionit është konkluduar se kontrata për blerjen e mjetit është kryer në datën 22.02.2012, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesat me anë të mandateve të arkëtimit 5 ditë më parë.*

23.3 Në Kolegji, për të parë mundësinë e krijimit të shumës 6500 euro të likuiduar deri në datën 17.02.2012, janë studiuar llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, sipas të cilave, në llogarinë bankare me nr. {***} të subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, dhe rezulton se gjendja në fillim të vitit 2012 është 114.648,55 lekë, vlera këto të mbartura vit pas viti dhe të krijuara kryesisht nga të ardhurat nga paga. Kësaj shume i janë shtuar të ardhurat nga pagat për muajin janar dhe shkurt në vlerën 235.757 lekë dhe gjithashtu llogaria është kredituar edhe në vlerën 7.000 lekë për të kompensuar shpenzimet e transportit. Nga janari i vitit 2012 deri në datën 17.02.2012, subjekti ka tërhequr shumën 290.000 lekë. Subjekti ka paguar këste kredie deri në datën 17.02.2012, vlerën -23,710.57 lekë, por ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, kjo vlerë është paguar nga gjendja e llogarisë bankare dhe jo nga të ardhurat e tërhequra nga subjekti i rivlerësimit. Nga e njëjta llogari është kryer edhe pagesa për shpenzimet e telefonit të subjektit. Llogaria e subjektit deri në datën 22.02.2012 ka qenë në vlerën 104.214,67 lekë. Në asnjë nga llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit nuk rezulton të jetë kryer tërheqje deri në datën 17.02.2012.

23.4 Në përfundim të analizës në Kolegji lidhur me pasurinë automjet tip “Vokswagen”, rezultoi se pagesat e mandatarkëtimit në vlerën 6500 euro, në datat 25.01.2012 dhe 17.02.2012 janë kryer disa ditë përpara lidhjes së kontratës së shitjes së automjetit të subjektit të rivlerësimit, e

cila mban datën 22.02.2012. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e blerjes së automjetit është arkëtuar që në datën 25.01.2012, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të kryente pagesat në vlerën 6500 euro për automjetin deri në 17.02.2012, për një vlerë negative prej 695.735,87 lekësh. Kolegji çmoi që kjo mungesë e burimeve të ligjshme që ka shërbyer për blerjen e automjetit të subjektit të rivlerësimit, nuk është e tillë për t'u renditur si pamjaftueshmëri që çon në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale

24. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka bërë rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar, por jo vetëm, në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të tij të kryer nga KLP-ja me raportin nr. {***} prot., datë 02.04.2019. Gjatë analizimit të këtij raporti, Komisioni ka konstatuar disa problematika në një prej dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit. Komisioni, pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja dhe dosjeve ku është bazuar ky raport, ka konstatuar se në tërësi, për të tria dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, nuk kanë rezultuar problematika të natyrës profesionale. Po ashtu, edhe në tri dosjet që u përkasin pesë dosjeve të shortuara, nuk kanë rezultuar problematika, madje ndaj vendimmarrjeve të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se nuk është ushtruar ankim, për pasojë vendimet kanë mbetur në fuqi sipas zgjidhjes së dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Por, Komisionit, nga aktet e administruara në fashikullin që i përket procedimit penal nr. {***}/2014 (referuar dosjes nr. {***}, përfshirë në pesë dosjet e shortuara), të pushuar nga subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 30.07.2015, i ka rezultuar se subjekti ka disa mangësi, të cilat i ka arsyetuar në vendimin objekt shqyrtimi.
25. Konkluzionet e Komisionit për kriterin e aftësisë profesionale: *Nën të gjitha argumentet dhe konstatimet e sipërpërmendura, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 73 dhe nenit 74/4 të ligjit nr. 96/2016, si dhe me “rregulloren për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. {***}, datë 19.11.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm. [...] Në përfundim, lidhur me vlerësimin profesional, trupi gjykues, duke pasur në konsideratë: nenin 43, pika 1, nenin E të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”; nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë [...]” – arsyeton se mangësitë e konstatuara në dosjen penale nr. {***}/2014, të referuara sa më sipër, nuk janë të mjaftueshme për ta vlerësuar me mangësi profesionale, por i çmon ato në vlerësimin tërësor të subjektit.*
26. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vendimi i Komisionit lidhur me kriterin e aftësisë profesionale është jologjik dhe konstatimet e tij nuk qëndrojnë, pasi sipas tij ka hetuar çështjen dhe ka marrë vendimin e pushimit në bazë të fakteve dhe provave të vlerësuar në mënyrë të drejtë. Subjekti i rivlerësimit thekson se është ngarkuar të ushtrojë ndjekjen penale në këtë çështje disa muaj nga data e cila dyshohej se kishte ndodhur akti korruptiv. Në këto kushte, ishte e pamundur të kryheshin veprime hetimore proaktive, sepse nuk u çmua efektive. Pasi u dëgjuan të gjitha përgjimet e kryera, u administrua vendimi i gjykatës, i cili konfirmoi qëndrimin e mbajtur nga prokurorja që po hetohej dhe u analizuan të gjitha provat në tërësi, nuk u bë e

mundur të provohej ekzistenca e faktit penal dhe, për këtë arsye, u vendos pushimi i çështjes penale. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka kryer hetimin dhe ka marrë vendimin në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

26.1 Kolegji vëren se, sipas dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se procedimi penal nr. {***/2014 është regjistruar në Prokurorinë për Krime të Rënda me aktin që mban datën 30.07.2014, për veprën penale të "Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Dokumenti ligjor që i nënshtrohet vlerësimit, si një nga pesë dosjet e zgjedhura me short, është "vendim pushimi" i procedimit penal nr. {***/2014, me datë vendimi 30.07.2015. Kolegji konstaton se çështja penale është regjistruar fillimisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. procedimi {***/2013, në bazë të informacionit të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme. Për shkak të kompetencës lëndore, hetimet janë kryer më pas nga Prokuroria për Krime të Rënda, Tiranë. Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është regjistruar procedimi penal nr. {***/2012 për veprën penale "vrasje në rrethana të tjera cilësuese", mbetur në tentativë dhe "mbajtje pa leje e armëve luftarake" në ngarkim të personit nën hetim F. N. Prokurorja e çështjes dyshohet se ka vepruar në shkelje të nenit 24, pika 4 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, nenit 3/b e vijues të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë". Kjo ka ardhur si qëllim i shmangies së kontrollit të ligjshmërisë së drejtuesit të Prokurorisë Mat, duke vendosur pushimin e hetimeve për dy plagosje me armë zjarri në ngarkim të shtetasit F. N. dhe e ka marrë këtë të fundit në cilësinë e të pandehurit vetëm për veprën penale të "armëmbajtjes pa leje", parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Këto veprime dyshohet se janë bërë kundrejt përfitimeve të paligjshme nga ana e prokurores së çështjes. Drejtuesi i Prokurorisë Mat ka shfuqizuar aktet e mësipërme të prokurores së çështjes, duke e zëvendësuar atë dhe oficerin e policisë gjyqësore.

26.2 Kolegji vëren se në vazhdimësi, çështja ku hetohej prokurorja, për shkak të ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale, nenit 75/a, është transferuar për shkak të kompetencës lëndore në Gjykatën pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda, Tiranë, ku prokuror i çështjes ishte subjekti i rivlerësimit. Janë kryer veprime hetimore teknike nëpërmjet transkriptimit të bisedave telefonike. Subjekti i rivlerësimit konkludon në vendimin e pushimit se nga veprimet e kryera nuk ka rezultuar kryerja e ndonjë veprimtarie që të përmbajë elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, për të cilën është filluar procedimi penal apo të ndonjë vepre tjetër penale. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin e datës 30.07.2015 për pushimin e procedimit penal, duke u bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja "b" e Kodit të Procedurës Penale, me arsyetimin se fakti i hetuar nuk ka asnjë element të ndonjë vepre penale. Nga aktet që gjenden në dosje, nuk rezulton që vendimi i pushimit të jetë ankimuar nga palët.

26.3 Komisioni, nga analiza e akteve të këtij fashikulli penal, konstatoi disa veprime për të cilat i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës: (a) Nga aktet e fashikullit penal duket sikur regjistrimi i këtij procedimi penal, i urdhëruar nga subjekti i rivlerësimit, është bërë formalisht, pasi nuk është kryer asnjë veprim hetimor për të konkluduar në lidhje me përfundimin e hetimit. (b) Duket se nuk është çmuar niveli i provave të depozituara prej shfuqizimit të akteve të ndërmarra nga drejtuesi i Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, ndaj prokurores së çështjes që ndiqte procedimin penal të vitit 2012, si dhe i të gjitha provave të tjera të ndërmarra nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfshirë këtu përgjimet e numrave të telefonit, raportet e vëzhgimeve ambientale, si dhe mospranimin e ankimit të prokurores së

kallëzuar për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” nga drejtuesi më i lartë i Prokurorisë së Përgjithshme.

26.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e rezultateve të hetimit të dërguara në Komision më datë 28.10.2019, lidhur me këtë procedim penal dhe për arsyet e kalimit të barrës së provës, ka sqaruar se: *Procedimi penal në fjalë me nr. {***/2014 është regjistruar në Prokurorinë për Krime të Rënda me aktin e datës 30.07.2014, me të cilin janë pranuar aktet e procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka shpallur moskompetencën lëndore për shkak të ndryshimit të ligjit ku korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë u bë kompetencë e Gjykatës për Krimet e Rënda. Pas regjistrimit të këtij procedimi, së bashku me oficerin e policisë gjyqësore janë kryer analizimi i gjitha tabulateve telefonike, vëzhgimeve dhe duke u nisur nga natyra e veprës penale për të cilën po hetohej, duke marrë në konsideratë se çështja e kishte humbur aktualitetin për shkak të kohës së gjatë që kishte kaluar nga kryerja e këtyre veprimeve me metoda speciale deri në regjistrimin e akteve në Prokurorinë për Krime të Rënda, kemi marrë informacion në lidhje me çështjen për të cilën kishte filluar ky procedim. Pra, është administruar vendimi me nr. {***}, datë 16.04.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me të cilin është deklaruar fajtor shtetasi F. N. për veprat penale të “Vrasjes nga pakujdesia”, parashikuar nga nenet 85 dhe 22 dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga neni 278, paragrafi 2 i Kodit Penal. Data e këtij vendimi është disa muaj para datës së regjistrimit të çështjes në Prokurorinë për Krime të Rënda. Prandaj nuk u çmua të delegoheshin veprime të reja hetimore pasi ato ishin kryer qëkur dosja ndodhej në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nuk kishin dhënë rezultat. Vendimi nr. {***}, datë 16.04.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Mat, ndërkohë me vendimin {***}, datë 04.06.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë është ndryshuar vendimi nr. {***}, datë 16.04.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe shtetasi F. N. është dënuar vetëm për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”. Një muaj më vonë mbas vendimit të Gjykatës së Apelit, kam marrë vendimin për pushimin e çështjes.*

26.5 Kolegji vëren se, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e procedimit penal nr. {***/2014, si veprime të kryera nga subjekti i rivlerësimit rezultojnë vendimi i datës 30.07.2014, “Për pranimin e akteve dhe regjistrimin e procedimit penal”, si dhe vendimi i datës 30.07.2015, “Për pushimin e procedimit penal nr. {***/2014. Në dosje gjenden materialet hetimore të kryera nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat, si dhe më pas me kallëzimin e prokurores për korrupsion pasiv i shtohen edhe veprimet hetimore të kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kur dosja ishte pa u transferuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, pas ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale. Nga ky fashikull hetimor i marrë në tërësi, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë drejtuar veprime hetimore, madje nuk rezultojnë të jenë kryer veprime as nga oficeri i policisë gjyqësore i caktuar nga subjekti i rivlerësimit në vendimin për regjistrimin e akteve të procedimit penal.

26.6 Nga sa më sipër parashtruar, Komisioni me të drejtë ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore për këtë procedim penal, për më tepër kur ndaj personit të akuzuar me funksion prokuror kishte vendimmarrje të zëvendësimit për vijimin e hetimeve ndaj të pandehurit nga një tjetër prokuror, si dhe kishte vendimmarrje të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili nuk kishte pranuar ankimin e paraqitur nga prokurorja që dyshohej për korrupsion pasiv në këtë procedim penal të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e aftësisë profesionale, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar dhe nuk ka marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e

përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, si dhe mbledhur provat sipas parashikimeve të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Megjithatë, në vlerësimin e Kolegjit, problematika si e vetme e konstatuar në këtë rast, nuk është e mjaftueshme për ta klasifikuar subjektin e rivlerësimit me “mangësi profesionale”, sipas nenit 44, pika b e ligjit nr. 84/2016.

27. Trupi gjykues i Kolegjit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, mbështetur në tërësinë e konkluzioneve të mësipërme dhe në legjislacionin e zbatueshëm, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni, në përputhje me nenin Dh, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, çmoi se vendimi i Komisionit nr. 202, datë 06.11.2019, është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi, pasi:

27.1 Lidhur me kriterin e figurës, edhe për Kolegjin subjekti i rivlerësimit rezultoi me probleme serioze gjatë kontrollit dhe vlerësimit të këtij kriteri, për shkak të kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Rrethana faktike dhe ligjore këto, që e bëjnë të pamundur subjektin e rivlerësimit për vazhdimin e detyrës nga njëra anë dhe nga ana tjetër, të mjaftueshme për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

27.2 Sa u përket shkaqeve të tjera të ankimit të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuar nga Kolegji, disa prej të cilave rezultuan të bazuara, u vlerësuan si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 202, datë 06.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 31.03.2021, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi